UDHËZIM
Nr.29, datë 27.12.2011

PËR DISA SHTESA NË UDHËZIMIN NR.1, DATË 8.1.2009 "PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT PËR PËRDORIMIN E APARTEVE TELEVIZIVE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe nenit 11 të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", Ministri i Financave dhe Drejtori i Përgjithshëm i Radiotelevizionit Shqiptar

UDHËZOJNË:

Në udhëzimin nr.1, datë 8.1.2009 "Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për përdorimin e aparteve televizive", të ndryshuar, bëhen shtesat e mëposhtme:

Pas pikës 2 shtohen pikat 2.1, 2.2 dhe 2.3 , me këtë përmbajtje:

"2.1 Nuk janë subjekt i pagimit të tarifës së shërbimit për përdorimin e aparteve televizive, konsumatorët e mëposhtëm familjarë:

a) Invalidët dhe veteranët e luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar, invalidët e punës, të verbërit, invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë që e fitojnë këtë status në bazë të ligjit nr.7874, datë 17.11.1994 "Për statusin e veteranit të Luftës kundër Pushtuesit Nazifashist të Popullit Shqiptar", të ndryshuar, ligjit nr.8098, datë 28.3.1996 "Për statusin e të verbërit" dhe ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit".

Veterani i luftës, invalidi i luftës apo i punës, personat e verbër, si dhe të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë duhet të paraqesin pranë zyrës së "CEZ shpërndarje" sh.a., në momentin e pagesës së faturës së energjisë elektrike, librezën përkatëse, së bashku me dokumentin e identifikimit të personit që përfiton përjashtimin nga tarifa. Nëpunësi i zyrës së "CEZ shpërndarje" sh.a., mban një kopje të librezës, në të cilët vendoset shënimi "përjashtuar nga tarifa".

2.2 Nuk janë subjekt i pagimit të tarifës së shërbimit për përdorimin e aparteve televizive, konsumatorët e mëposhtëm jofamiljarë:

a) përfaqësitë diplomatike të akredituara në Republikën e Shqipërisë, në bazë të parimit të reciprocitetit;

b) bashkësitë fetare që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave;

c) faturimi i energjisë elektrike për aktivitete, të tilla si: miniera, ujësjellësa, puset e naftës, furnizimi i antenave të telefonisë celulare dhe garazhe të mjeteve lëvizëse;

d) në rastet kur palë në kontratën e konsumit të energjisë elektrike është një subjekt që operon në sektorin e ndërtimit, tarifa llogaritet dhe paguhet nga momenti i kalimit të kontratës në emër dhe për llogari të personit fizik, juridik apo individit pronar i ambientit për të cilin faturohet energjia.

2.3 Institucionet e përcaktuara në shtojcën nr.1, bashkëlidhur këtij udhëzimi, i përcjellin kompanisë "CEZ shpërndarje" sh.a., brenda datës 15 janar të çdo viti, listën emërore të kategorive të përjashtuara nga pagimi i tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televizive, si dhe gjatë vitit përditësimet përkatëse, nëse ka."

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode
DREJTORI I PËRGJITHSHËM
I RADIOTELEVIZIONIT SHQIPTAR
Petrit Beci